



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Monitorimi i zbatimit të Strategjisë për Cilësinë e Ajrit 2013-2022

Raporti i parë i progresit të zbatimit
(Qershor 2021 - Dhjetor 2022)

Shkurt, 2023

I. PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE

Strategjia për Cilësinë e Ajrit ka për qëllim të zhvillojë dhe zbatojnë instrumentet e caktuara, për të ngritë cilësinë e jetës, duke siguruar bazën për përmirësim të cilësisë së ajrit, kornizë me të cilën do të arrihet mbrojtja dhe zvogëlimi i ndotjes së ajrit, në pajtim me standardet e përcaktuara të BE dhe parimet e praktikave më të mira.

Hartimi i Strategjisë për Cilësinë e Ajrit është bazuar në Programin dhe Vendimet e Qeverisë së Kosovës, si dhe një numër studimesh dhe analizash relevante dhe në strategjitë sektoriale. Vëmendje e veçantë i është kushtuar përputhshmërisë së këtij dokumenti me acquis të BE, të obligueshme për Kosovën, në kuadër të anëtarësimit në BE.

Strategjia për Cilësinë e Ajrit cakton objektivat për cilësinë e ajrit dhe politikat alternative për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së ajrit, që do të sigurojnë përfitime të rëndësishme në përmirësimin e cilësisë së ajrit dhe ndihmesë në mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimit të qëndrueshëm. Objektivat dhe masat e identifikuara në këtë Strategji, përfshinë sektorin e amvisërisë, energjisë, industrisë dhe transportit të cilat kanë filluar të zbatohen përmes aktiviteteve të përcaktuara në Planin e Veprimit për Cilësinë e Ajrit. Zhvillimi i këtyre aktiviteteve është elaboruar në vijim.

Procesi i punës dhe aleanca strategjike ndërmjet sektorit publik, nivelit të politikave dhe shoqërisë civile, është një shembull i vlerës së shtuar të kësaj Strategjie.

Integrimi i mëtejshëm i shoqërisë civile në procesin e zbatimit të Strategjisë për Cilësinë e Ajrit do të forcohet mëtej nga puna e MMPHI dhe diskutimi i vazhdueshëm mbi zhvillimin e aktiviteteve në një shkallë më të gjerë të koordinimit për temat lidhur me zhvillimet.

Objektivat strategjike që synohen të arrihen nëpërmjet kësaj strategjie janë: implementimi i legjislacionit për ajr, ulja e emisioneve nga burimet e veçanta, ulja e emisioneve nga burime mobile, ulja e emisioneve të Gazeve Serrë, ulja e emisioneve nga aktivitetet publike.

Arritja e objektivave të kësaj Strategjie, janë të planifikuara për dhjetë vitet e ardhshme (2013-2022), me fokus në harmonizimin e mëtutjeshëm të legjislacionit me dispozitat e BE-së, zbatimin e tij, zbatimin e standardeve përmes politikave të përcaktuara, në koordinim edhe me strategjitë dhe planet tjera të veprimit.

II. PROGRESI NË ZBATIMIN E OBJEKTIVAVE TË DOKUMENTEVE STRATEGJIKE

Strategjia për Cilësinë e Ajrit 2013-2022 është zhvilluar mbi parimet e Programit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, duke marrë në konsideratë edhe dokumentet tjera strategjike që do të zbatohen ose janë në zbatim e sipër.

Objektivat e përcaktuara nga kjo Strategji përfshinë sektorë të ndryshëm të cilët ndikojnë në mënyra të ndryshme në ndotjen e ajrit.

Sa i përket progresit të shënuar në zbatimin e Strategjisë, vlen të cekët që me zhvillim e projektit “Zhvillimi i Kapaciteteve për Kontrollin e Ndotjes së Ajrit”, faza II mbështetur nga Agjencioni Japonez për Bashkëpunim Ndërkombëtar (JICA), nga Qershori 2022 janë realizuar aktivitete me fokus mbrojtjen e cilësisë së ajrit nga sektorët e ndryshëm të ndotjes së ajrit.

PROGRES KUNDREJT OBJEKTIVIT 1: Implementimi i legjislacionit për ajër

Prioriteti më i lartë i përcaktuar nga masat e dala është ndërtimi i sistemit më efektiv për menaxhimin e cilësisë së ajrit. Në kuadër të zbatimit të këtij objekti vlen të cekët që këtë vit është publikuar në Gazetën zyrtare Ligji nr. 08/1-025 për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja. Ky ligj ka për qëllim të përcaktojë kompetencat dhe përgjegjësitë e institucioneve për të siguruar të drejtën e qytetarëve për të jetuar në një mjedis me ajër të pastër, duke mbrojtur shëndetin e njeriut, faunën, florën dhe vlerat natyrore e kulturore të mjedisit nga ndotja e ajrit. Ky ligj është në përputhshmëri me Direktivën 2008/50/EC për cilësinë e ajrit mjedisor; Direktivën 2004/107/EC për arsenin, kadmiumin, merkurin, nikelin dhe hidrokarburet aromatike policiklike në ajrin mjedisor dhe Direktivën 2016/2284/EC për tavanet e emisioneve kombëtare për disa ndotës atmosferikë, e cila ndryshon Direktivën 2003/35/EC dhe shfuqizon Direktivën 2001/81/EC.

OBJEKTIVI SPECIFIK 1. Krijimi i Sistemit Kombëtar të Inventarit për Ajër

Zbatimi i aktivitetit për përgatitjen e Inventarit të ajrit është mbështetur nga donacioni i Agjencionit Japonez për Bashkëpunim Ndërkombëtar (JICA) me projektin - Zhvillimi i Kapaciteteve për Kontrollin e Ndotjes së Ajrit në Republikën e Kosovës.

Inventari i emisioneve është përgatitur për regjionin e Prishtinës që përfshinë Komunën e Prishtinës, Fushë Kosovës dhe Obiliqit. Aktivitetet janë zhvilluar në tri perioda.

Në periudhën e parë, aktivitetet filluan me ligjërata në mënyrë që grupi i inventarit ta kuptojnë thellësisht inventarin e emisioneve.

Në periudhën e dytë, JICA zhvilloi dosjet e llogaritjes së inventarit të emisioneve duke i përdorur të dhënat e mbledhura dhe paralelisht G.P. me mbështetjen e JICA-it mësuan procedurën konkretet të llogaritjes përmes TNP-së.

Në periudhën e tretë, G.P. mësuan aktivitetin praktik dhe konkret për përgatitjen e inventarit të emisioneve përmes TNP. Në veçanti përmes përpilimit të inventarit të emisioneve me përditësimin e të dhënave vjetore siç është vjetari statistikor, G.P. mësuan për nevojën e kontrollit të cilësisë dhe krijimin e kornizës institucionale për përgatitjen e inventarit të emisioneve.

Paralelisht, pasi që krijimi i kornizës institucionale për përgatitjen e inventarit të emisioneve është duke përparuar, JICA ka gjykuar se pala kosovare tashmë është në gjendje në mënyrë të pavarur ta bëjë hapin e parë drejt përgatitjes së vazhdueshme të inventarit të emisioneve në të ardhmen.

Si rezultat i inventarit të emisioneve, është bërë e qartë se emisionet nga IDM-të përbëjnë shumicën e ndotësve në Zonën e Prishtinës, por në të njëjtën kohë, emisionet nga ngrohja në amvisëri, biznese të vogla, emisionet nga automjetet janë mjaft të mëdha.

Tabela 1. Rezultatet e Seminareve dhe Punëtorive të mbajtura për Grupin e Inventarit

Pasqyra	Pjesëmarrës
<p>Punëtori dhe Seminare për Inventarin e Emisioneve (në total 151)</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Diskutimi i Planit të punës dhe përmbajtjes së secilit aktivitet të grupit të Inventarit ➤ Përgatitja e Inventarit të Emisioneve për ndotës shtesë të ajrit në zonë shtesë të synuar të Prishtinës ➤ Aktivitetet e Sigurimit të cilësisë dhe Kontrollit të cilësisë dhe KC) për inventarin e emisioneve të përgatitur nga H/L ➤ Ekzaminimi i përgatitjes së inventarit të emisioneve përdorur të dhënat nga Lejet ➤ Diskutimi dhe ekzaminimi për procedurën e llogaritjes së emisioneve për nënkategoritë të cilat nuk janë vlerësuar. 	<p>Në total</p> <p>Pjesëmarrës ishte 92</p>

Aktiviteti 1.1. Përmirësohet inventari aktual i emisioneve duke mbuluar ndotës shtesë të ajrit dhe zonë shtesë të synuar të Prishtinës

Përmes realizimit të projektit “Zhvillimi i Kapaciteteve për Kontrollin e Ndotjes së Ajrit në Republikën e Kosovës” ka filluar edhe përgatitja e inventarit të emisioneve të ndotësve shtesë të ajrit si PM2.5 dhe NH3.

Gjendja aktuale e llogaritjes së emisioneve për secilin sektor të Inventarit të Emisioneve është paraqitur në Tabelën 2.

Tabela Error! No text of specified style in document.. Gjendja aktuale e llogaritjes së emisioneve për secilin sektor të Inventarit të Emisioneve

Sektori/Kategoria	
Kategoria e Industrive të Energjisë	Në vazhdimësi
Kategoria e Industrisë së Prodhimit	Përmirësimi i procedurës së llogaritjes është në vazhdim e sipër përmes Aktiviteteve
Kategoria e Transportit	Në vazhdimësi
Kategoria e djegieve të vogla (amvisëritë)	Varësisht nga arritjet e rezultateve, mund të jetë e nevojshme të rishqyrtohen faktorët e emisionit.
Kategoria e djegieve të vogla (Industria e shërbimeve)	Mbledhja e të dhënave dhe llogaritja e emisioneve janë në vazhdim e s Shqyrtimi i përmirësimit të procedurës së llogaritjes është duke vazhd
Sektori IPPU	Përmirësimi i procedurës së llogaritjes është në vazhdim e sipër
Sektori i Bujqësisë	Përfunduar. Informacioni për Bujqësinë në Kosovë është duke u mbledhur në vazhdimësi.
Sektori i Mbeturinave	Përfunduar.

Aktiviteti 1.2. Përmirësohet procedura e përgatitjes së inventarit të emisioneve përmes shfrytëzimit të të dhënave të mbledhura nën skemën e Lejeve

Në nëntor 2022 u mbajtën disa punëtori me palët me interes nga AMMK e cila është agjencia e cila bënë përgatitjen e inventarit të emisioneve, dhe DMMU e cila është përgjegjëse për planifikimin dhe vlerësimin e masave të kontrollit të ndotjes së ajrit dhe rishikimin e Lejeve PKIN dhe Lejeve Mjedisore

(Sistemi Kombëtar i Lejeve). Në punëtori anëtarët e H/L shqyrtuan dokumentet e dorëzuara nga secili operator në MMPHI lidhur me Sistemin Kombëtar të Lejeve dhe nxorën informacion të dobishëm për inventarin e emisioneve, llogaritjen e simulimit dhe masat e kontrollit të ndotjes së ajrit. Për më tepër, është zhvilluar formulari për regjistrimin e të dhënave për të mbledhur dhe analizuar informacione të dobishme. Pasi të merren disa nga të dhënat që do të regjistrohen, do të punësohen studentët dhe do ta kryejnë punën e regjistrimit të të dhënave.

Në nëntor 2022, u mbajt një punëtori me palët me interes nga Komuna e Prishtinës, AMMK dhe DMMU për t'i shqyrtuar dhe diskutuar të dhënat në dispozicion në kuadër të Lejeve Mjedisore Komunale (Sistemi Lokal i Lejeve). Përmes këtyre diskutimeve u zhvillua formulari për regjistrimin e të dhënave për të mbledhur informacione të dobishme për inventarin e emisioneve dhe masat e kontrollit të ndotjes së ajrit nga të dhënat e Sistemit të Lejeve Komunale.

Aktiviteti 1.3 Përmirësohet inventar i emisioneve duke zhvilluar procedurën e llogaritjes për nënkategoritë që nuk janë vlerësuar në inventarin aktual të emisioneve

Për sa i përket llogaritjes së emisioneve nga industria e gurorëve, anëtarët e H/L aktualisht janë duke e zhvilluar procedurën e llogaritjes bazuar në përvojën nga projektet e donatorëve të tjerë siç është projekti i MCC/MFK.

Tabela 3. Rolet dhe Përgjegjësitë e Organizatave Relevante për Përgatitjen e Inventarit të Emisioneve

	Rolet dhe Përgjegjësitë
MMPHI/AMMK	<p>Publikimi i inventarit të emisioneve</p> <p>Dorëzimi i inventarit të emisioneve tek EEA</p> <p>Përgatitja e inventarit të emisioneve</p> <p>Përgatitja, konfirmimi dhe miratimi i planit të përmirësimit për përgatitjen e inventarit të emisioneve</p> <p>Kryen punën aktuale në përpilimin e inventarit të emisioneve</p> <p>Përgjegjëse për llogaritjen, përpilimin dhe arkivimin e inventarit të emisioneve si dhe menaxhimin e të gjitha të dhënave</p> <p>Kontrolli i cilësisë</p> <p>Dërgon inventarin e emisioneve tek Grupi i modelimit të simulimit (AMMK/IHMK) për llogaritjen e hartës së përqendrimit të cilësisë së ajrit në nivelin e tokës</p>

	Dërgon inventarin e emisioneve tek MEA (Ministri) për politik bërje
MMPHI/ DMNU/DMNI	<p>Politik bërja për cilësi të ajrit duke përdorur inventarin e emisioneve të ndotësve të ajrit</p> <p>Politik bërja për cilësi të ajrit duke përdorur hartën e përqendrimi të cilësisë së ajrit në nivelin e tokës nën llogaritjen e modelimit të simulimit</p>
MMPHI/AMMK/IH MK	Informacioni prapa-kthyes për përmirësimin e emisioneve duke përdorur rezultatet e modelimit të simulimit
Organizatrat të cilat sigurojnë të dhëna	<p>Ofrimi i të dhënave</p> <p>Kontrolli i cilësisë për të dhënat e siguruar</p> <p>Vërtetimi i vlefshmërisë së të dhënave</p> <p>Përgjigja ndaj pyetjeve për sa i përket të dhënave që janë siguruar</p>




Figura. 1 Korniza Institucionale për Inventarin e emisioneve




Figura 2. Zona e synuar për Përgatitjen e Inventarit të Emisioneve

AKTIVITETI 2

Aktiviteti 2.1 Vlerësimi i cilësisë së ajrit dhe parashikimet e ndotjes- modelim/ simulimet

Zbatimi i aktivitetit për vlerësimin e cilësisë së ajrit dhe parashikimet e ndotjes- modelim/simulimet, është mbështetë nga donacioni i Agjencionit Japonez për Bashkëpunim Ndërkombëtar (JICA) me projektin - Zhvillimi i Kapaciteteve për Kontrollin e Ndotjes së Ajrit në Republikën e Kosovës faza I dhe II.

Projekti zbatoi simulimin e ndotjes së ajrit në Zonën e Prishtinës, u përpoq ta bëjë vlerësimin e efektit dhe vlerësimin e kontributit të secilit burim të emisioneve.

Kjo është hera e parë që grupet punuese u trajnuan për përgatitjen e inventarit të emisioneve dhe modelin e simulimit të dispersionit dhe për këtë arsye Projekti ka mbështetur përgatitjen e manualeve për ta mbajtur qëndrueshmërinë e kryerjes së përgatitjes së inventarit të emisioneve dhe simulimit të dispersionit.

Inventari i emisioneve dhe simulimi i ndotjes së ajrit janë vegla shumë efektive për ta kuptuar gjendjen e cilësisë së ajrit dhe është e rëndësishme që këto aktivitete të vazhdojnë.

Tabela 4. Rezultatet e Seminareve dhe Punëtorive të mbajtura

Pasqyra	Pjesëmarrës në total
Punëtoritë për Modelimin e Simulimit <ul style="list-style-type: none"> ➤ Shqyrtimi i Projektit të Fazës 1 ➤ Shpjegimi i Planit të punës të Fazës 2 dhe Rezultatit 5 ➤ Përmbledhja e modelit WRF ➤ Masat e kontrollit të ndotjes së ajrit duke përdorur Modelimin e simulimit ➤ Pasqyra e përgjithshme e ekzekutimit të WRF 	Në total 19 pjesëmarrës

Aktiviteti 2.2. Rritja e besueshmërisë së modelimit të simulimit me përmirësimin e modelit meteorologjik

Në shtator dhe tetor 2022 janë mbajtur shumë punëtori me H/L për modelimin e simulimit dhe të dhënat e SMCA-ve. Gjatë punëtorive janë shpjeguar aktivitete e përgjithshme përmes shqyrtimit të Projektit të Fazës 1 dhe shpjegimit të Planit të punës për Fazën 2 . Gjithashtu u prezantua modeli meteorologjik që do të përdoret në Fazën 2 duke treguar konceptet e modelit dhe rastet studimore nga Japonia për ta rritur njohurinë bazë për modelimin e simulimit.

Në shtator 2022, në IHMK u instalua kompjuteri me performancë të lartë për modelin meteorologjik. JET-i instaloi modelin meteorologjik ËRF në Kompjuter dhe përgatiti mjedisin për ekzekutimin e modelit si mbledhja e të dhënave të nevojshme për ekzekutimin e modelit dhe përgatitja e veglave për analizën e rezultateve të dala. Në punëtorinë e modelimit të simulimit JET-i dhe H/L në realitet përdorën Kompjuterin për t'i demonstruar operimet lidhur me ekzekutimin e modelit meteorologjik. Të kuptuarit e modelimit të simulimit nga H/L u promovua përmes demonstrimeve dhe përmes të treguarit të operimeve të modelit dhe shembujve të rezultateve të dala.

Paralelisht, do të rishikohet modelimi i simulimit i krijuar në Projektin e Fazës 1 dhe do të fillojnë trajnimet praktike për t'i krahasuar dhe verifikuar të dhënat e SMCA-ve me rezultatet e llogaritjes së modelimit të simulimit. Për më tepër, pjesëmarrësit nga universitetet vazhdojnë të marrin pjesë në punëtoritë e modelimit të simulimit dhe është duke u krijuar një bashkëpunim i mirë përmes ndihmës për anëtarët e tjerë të H/L që t'i kuptojnë rezultatet

Aktiviteti 2.3. Vlerësimi i vlefshmërisë së modelimit të simulimit duke i krahasuar rezultatet e tij me të dhënat nga SMCA-të

Janë marrë të dhënat e monitorimit të cilësisë së ajrit për 2019 e tutje dhe janë analizuar për mesataret mujore në vitin 2022, ndryshimet sipas ditës së javës dhe ndryshimet ditore sipas stinëve. Është konfirmuar se cilësia e të dhënave në përgjithësi është përmirësuar dhe numri i vlerave që mungojnë është ulur që nga viti 2020. Në veçanti, të dhënat e përqendrimit të SO₂ të cilat nuk ishin të besueshme në Fazën 1 dhe të dhënat e monitorimit të PM_{2.5} në stacionin e IHMK-së, të cilat kishin munguar, tani janë në dispozicion. Të dhënat e monitorimit do të vazhdohet të ekzaminohen nga afër për t'i hequr vlerat e parregullta dhe më pas do të përdoren për krahasim me rezultatet e modelimit të simulimit në të ardhmen.







Figura 3 . Rrjedha e llogaritjes së programeve të modelit të simulimit



Vlera kufitare për shëndetin e njeriut

Mesatarja ditore: $50\mu\text{g}/\text{m}^3$, < 35 ditë/vit

Mesatarja vjetore: $40\mu\text{g}/\text{m}^3$



Vlera kufitare për shëndetin e njeriut

Vlera për orë: $200\mu\text{g}/\text{m}^3$, < 18 orë/vit

Mesatarja vjetore: $40\mu\text{g}/\text{m}^3$




Figura 4. Harta e përqendrimit e llogaritur me modelin e Simulimit (duke përfshirë emisionet nga termocentralet, automjetet, amvisëritë, bizneset e vogla, pluhurin Fugitiv nga mihja e thëngjillit dhe deponia e thëngjillit)

AKTIVITETI 3

Aktiviteti 3.1 Zhvillimi i sistemit për matjen e emisioneve në industry

Zbatimi i aktivitetit për Zhvillimi i sistemit për matjen e emisioneve në industri është mbështetë nga donacioni i Agjencionit Japonez për Bashkëpunim Ndërkombëtar (JICA) me projektin - Zhvillimi i Kapaciteteve për Kontrollin e Ndotjes së Ajrin në Republikën e Kosovës faza I dhe II.

Qëllimi i këtij aktiviteti është ngritja e kapaciteteve profesionale për matjen e gazit të shkarkuar (emisioneve) dhe matjen e pluhurit.

Projekti ka bërë matjen e gazit të shkarkuar për TC Kosova A dhe TC Kosova B. Projekti ka kuptuar gjendjen ekzistuese të emisioneve nga të dy TC-të dhe i ka përdorur këto të dhëna si të dhëna bazë për inventarin e emisioneve për IDM. Mirëpo, masat për zvogëlimin e emisioneve janë studiuar vetëm për TC Kosova A si përgjigje ndaj kërkesës së palës kosovare për t'i mos studiuar ato për TC Kosova B.

Si rezultat janë propozuar masat për zvogëlimin e pluhurit. TC Kosova A pranoi propozimin e masave dhe një pjesë e masave është aplikuar. TC Kosova A dhe JICA, kanë konfirmuar efektivitetin e masës përmes matjes së gazit të shkarkuar.

Për sa i përket burimeve të tjera të palëvizshme, JICA-i ka kryer matjen e gazit të shkarkuar për katër burime të tjera të palëvizshme pas matjeve në IDM. Bashkë me matjen e gazit të shkarkuar, JICA-i inspektoi rrjedhën e procesit të fabrikave dhe situatën e përdorimit të lëndës djegëse si dhe studioi masat për zvogëlimin e emisioneve. JICA-i ka propozuar masat për zvogëlimin e emisioneve për secilin burim.

Projekti ka kryer matjen e gazit të shkarkuar për objektet industriale (burimet e tjera të palëvizshme) në Kosovë me qëllim të të kuptuarit të situatës reale të emisioneve dhe studimit të masave për zvogëlimin e emisioneve.

Lista e burimeve të tjera të synuara të palëvizshme në Kosovë.

- i) Fabrika e Ferronikelit
- ii) Fabrika e blloqeve
- iii) Fabrika e asfaltit
- iv) Fabrika për riciklimin e vajrave

Aktiviteti 3.2. Inspektimi bazuar në matjen e gazit të shkarkuar sipas sistemit të Lejeve PKIN (IPPC) dhe rishikimi i mënyrës aktuale të inspektimit

Gjatë aktivitetëve në terren në shtator 2022, IHMK ka dhënë këshilla për mirëmbajtjen e pajisjeve për matjen e emisioneve për TC Kosova A dhe TC Kosova B. Për më tepër, IHMK ka kryer TNP për matjen e gazit nga oxhaku për ekipin e TC për matjen e emisioneve.

U zhvillua disa herë trajnimi bazik për IHMK-në, ekipin e Termocentraleve për matjen e emisioneve dhe të tjerët të përfshirë në matjen e emisioneve për t'i edukuar ata mbi metodat e llogaritjes, etj.

Një problem u konstatua në data llogerit e dhënë donacion gjatë dërgimit të ekspertëve të JICA-s (tetor 2015 deri në maj 2016). Pasi që data llogerit do të jetë i nevojshëm për matjen e emisioneve për burimet e palëvizshme rezidenciale të planifikuara për të filluar nga shkurti 2023, kur u kontrollua gjendja e data llogerit gjatë vizitës së JET-it në shtator 2022, u zbulua se ai kishte probleme. Edhe pse është marrë në konsideratë procedura e riparimit me shpenzime të palës kosovare, pasi është dashur të planifikohet buxheti i MMPHI-së një vit më parë dhe nuk ka mundur të sigurohet buxheti për riparim në kohë për matjen në shkurt 2023. Prandaj, duke marrë parasysh urgjencën e situatës, riparimi u krye në Japoni duke përdorur buxhetin e Projektit.

Aktiviteti 3.3 Vlerësohen emisionet nga burimet e palëvizshme rezidenciale përmes matjes së gazit të shkarkuar

Janë përgatitur matjet e emisioneve për burimet e palëvizshme rezidenciale (ngrohja dhe gatimi duke përdorur lëndë djegëse të ngurta si linjiti, druri dhe peleti), të cilat janë planifikuar nga fillimi i marsit deri në prill 2023. Gazi standard i përdorur në pajisjet e matjes së vazhdueshme të gazit nga oxhaku u ble në shtator 2022. Gjithashtu, u konfirmua gjendja e operimit të pajisjeve matëse të ofruara në Projektin e mëparshëm. Për më tepër, u zgjodhën burimet e palëvizshme rezidenciale siç janë shporetet dhe kaldaja me pelet që përdoren përgjithësisht në amvisëri, u siguruan lokacionet e instalimit dhe u blenë materialet dhe pajisjet përkatëse shpenzuese për matjen e emisioneve.

Paralelisht, lëndët djegëse të ngurta si linjiti, druri i zjarrit dhe peleti janë përgatitur paraprakisht, dhe analiza bazë e lëndës djegëse është kryer paraprakisht për t'i kuptuar karakteristikat themelore të këtyre lëndëve djegëse.

Aktiviteti 3.4. Vlerësohen emisionet nga automjetet duke përdorur pajisjet për inspektim

Qendra e Automjeteve të Kosovës (QAK) i organizon informacionet e regjistrimit bazuar në inspektimin e automjeteve. Me bashkëpunimin e DiA, JET-i konfirmoi se është e mundur të analizohen informacionet në lidhje me matjen e emisioneve. Për më tepër, Projekti u konsultua me DiA për rezultatet e marra dhe JET kërkoi QAK-u që të sigurojë të dhënat përkatëse të nevojshme shtesë.

Në aktivitetin 2.6, JET dhe DiA planifikojnë të kryejnë inspektime të gazit të shkarkuar duke përdorur pajisje për inspektimin e automjeteve për automjetet me emisione të larta të zbuluar përmes pajisjes për detektim nga larg (RSD). DiA planifikoi ta blinte një stacion mobil të inspektimit të automjeteve deri në

fund të vitit 2022, dhe gjithashtu konsideroi përdorimin e këtij stacioni në aktivitetin 2.6. Mirëpo, tenderi është rishpallur pasi nuk ka pasur ofertues. Nëse është i vështirë përdorimi i këtij stacioni, përmes diskutimit me DiA, është vendosur që si alternativë, matja e gazit të shkarkua përmes inspektimit të automjeteve mund të kryhet në QAK pasi që QAK-u kryen aktivitete që lidhen me regjistrimin e automjeteve të importuara dhe ka pajisje me precizitet dhe saktësi.

Aktiviteti 3.5. Matja e gazit të shkarkuar nga automjetet duke përdorur pajisjen për detektim nga larg

Lidhur me matjen e gazit të shkarkuar të automjeteve duke përdorur RSD të planifikuar për t'u zbatuar në vitin 2023, në aktivitetet në shtator dhe tetor 2022 JET-i zhvilloi takime me DiA dhe vizitoi pikat e zgjedhura të matjes. Duke qenë se bashkëpunimi i policisë rrugore është i nevojshëm për matje, ne kemi përgatitur një plan të matjes për policinë rrugore në bashkëpunim me DiA. Për më tepër, JET-i ka kryer punë përgatitore për prokurimin e pajisjeve për RSD.

Aktiviteti 3.5. Analiza e përbërjes së lëndës djegëse për automjete dhe burimet e palëvizshme rezidenciale

Në shkurt 2022, u krye analiza e përbërjes së lëndës djegëse për pajisjet e ngrohjes dhe gatimit në amvisëri. Rezultatet e analizës pritet të bëhen të qarta pas marsit 2023. JET planifikon t'i analizojë rezultatet e matjes së gazit të shkarkuar duke iu referuar rezultateve të analizës.

Për sa i përket analizës së lëndës djegëse për automjete, ne kemi planifikuar që analizën e lëndës djegëse ta nënkontraktojmë tek INKOS, por ata e kanë pezulluar përkohësisht biznesin. Në anën tjetër, u konstatua se ishin të mundshme analizat nga ana e departamentit të analizave të lëndës djegëse të doganës, kështu që analiza e lëndëve djegëse siç është benzina dhe nafta u ndryshuan për t'u kryer nga dogana.

AKTIVITETI 4

Aktiviteti 4.1. Analizë e gjendjes së stacioneve të MMPHI për monitorimin e cilësisë së ajrit dhe riparimi (kompletimi) i tyre

Zbatimi i aktivitetit për analizën e gjendjes së stacioneve të MMPHI për monitorimin e cilësisë së ajrit dhe riparimi (kompletimi) i tyre është duke u mbështetur nga donacioni i Agjencionit Japonez për Bashkëpunim Ndërkombëtar (JICA) me projektin - Zhvillimi i Kapaciteteve për Kontrollin i Ndotjes së Ajrit në Republikën e Kosovës dhe programit të Milenium Challenges Corporation (MCC)/Sfidat e Mijëvjeçrit Kosovë. Në bashkëpunim me dy donatorët e lartpërmendur u planifikuan aktivitetet rreth rehabilitimit të Stacioneve për Monitorimin e Cilësisë së Ajrit (SMCA) dhe u dakorduan që SMCA e regjionit të Prishtinës (pesë stacione) do të bëhet rehabilitimi nga ana e projektit të JICA ndërsa shtatë stacionet tjera të Kosovës do të rehabilitohen nga MCC/MFK.

Projekti realizoi rehabilitimin e analizatorëve në pesë SMCA në zonën e Prishtinës për ta përmirësuar besueshmërinë e të dhënave, dhe në të njëjtën kohë zëvendësoi kabinat e tri nga pesë SMCA-të me kabina më të mëdha për ta përmirësuar procesin e mirëmbajtjes. Për më tepër, për ta mbajtur saktësinë e të dhënave, Projekti bëri prezantimin për instrumentin e kalibrimit të analizatorëve, përgatitjen e manualit për O dhe M dhe trajnimin për O dhe M të analizatorëve. Për sa i përket rrjetit të komunikimit të të dhënave e cilësisë së ajrit, të dyja palët u pajtuat që MCC/MFK ta ndërtojë të gjithë rrjetin e komunikimit të të dhënave në Kosovë, dhe JICA në vend të kësaj zgjeroi planin origjinal për instalimin e një ekrani për shfaqjen e të dhënave në qytetin e Prishtinës në instalimin e një numri më të madh të ekraneve në Zonën e Prishtinës.

Përmes bashkëpunimit me MCC/MFK, aftësia e mbledhjes së të dhënave të cilësisë së ajrit është përmirësuar dukshëm. Mirëpo, ende ka probleme me sistemin e menaxhimit të të dhënave si p.sh. nuk është krijuar sistemi i kontrollit të parregullsive në të dhëna nga analizatorët dhe i vërtetimit të vlefshmërisë së të dhënave përfundimtare, dhe të kuptuarit e gjendjes së cilësisë së ajrit bazuar në të dhënat e mbledhura nuk është i mjaftueshëm.

Paralelisht, JICA, ka studiuar vendosjen optimale të SMCA-ve në Kosovë në mënyrë që të kuptohet gjendja e saktë e cilësisë së ajrit në Kosovë. JICA-i gjithashtu ka trajnuar grupet punuese në trajnimin (ushtrimin) për matje të cilësisë së ajrit në rast të emergjencave siç janë aksidentet mjedisore.

Për sa i përket rritjes së kapaciteteve për analiza në laboratorin e IHMK-së, JICA-i ka mbështetur matjen e gazit të shkarkuar me Metodën Standarde Referente. Metoda Standarde Referente është metodë të cilën e kërkon direktiva e BE-së për analizën e SO₂ dhe NO_X në gazin e shkarkuar nga IDM. Për sa i përket analizës së SO₂ dhe NO_X, JICA-i ka mbështetur analizat përmes trajnimit për mostrimin e gazit dhe funksionalizimin e Jon Kromatografit (këtu e tutje “JK”). Në të njëjtën kohë, meqenëse direktiva e BE-së gjithashtu kërkon analizën e Hg në gazin e shkarkuar nga IDM me djegie të thëngjillit, JICA-i ka mbështetur mostrimin dhe para-trajtimin për analizën e Hg dhe analizën me Spektrometër me Absorbim Atomik (këtu e tutje “AAS”).

Si çështje tjetër, ekziston shqetësimi për metalet e rënda në PM në ajër. JICA-i ka bërë mostrimin e PM në Drenas dhe Mitrovicë dhe i ka analizuar ato në Japoni. Të dyja rezultatet kanë treguar se disa komponentë tejkalojnë vlera udhëzuese të Japonisë. Prandaj, JICA-i gjithashtu mbështeti funksionalizimin e ICP-MS për ta bërë analizën e metaleve të rënda.

Është e rëndësishme që analizatorët të shfrytëzohen në plotësi përmes përdorimit të vazhdueshëm dhe që ato të shfrytëzohen për shumë lloje të analizave.

Tabela 5. Rezultatet e Seminareve dhe Punëtorive të mbajtura

Pasqyra	Pjesëmarrës në total
Punëtoritë, seminarët dhe Trajnimi-në-Punë (TNP) për SMCA (Në total 16 herë) <ul style="list-style-type: none"> ➤ Diskutimi për të dhënat dhe raportet mujore për SMCA ➤ Shqyrtimi i situatës së operimit dhe mirëmbajtjes për SMCA ➤ Seminari për rastet studimor të Japonisë për operimin dhe mirëmbajtjen e SMCA-ve ➤ Punëtorja për zhvillimin e listave kontrolluese ditore për SMCA ➤ TNP për kontrollin ditor të SMCA-ve 	Në total 16 pjesëmarrës
Punëtori dhe Seminare për Laboratorin mjedisor (në total 8 herë) <ul style="list-style-type: none"> ➤ Diskutimi për shkathtësitë për operimin dhe mirëmbajtjen e analizatorëve në Laboratorin mjedisor ➤ Diskutimi për formulimin e kornizës për Laboratorin mjedisor ➤ Ligjëratë për parimet e matjes dhe procedurat bazike të operimit 	Në total 20 pjesëmarrës

Aktiviteti 4.2. Rishikimi i aftësive aktuale për t'i operuar dhe mirëmbajtur Stacionet e Monitorimit të Cilësisë së Ajrit (SMCA)

Për ta mbajtur vazhdimisht në nivel të lartë saktësinë dhe besueshmërinë e vlerave të matjes së SMCA-ve është e nevojshme të zbatohen në mënyrë të duhur pikat e menaxhimit të paraqitur në Tabelën 5. Ka filluar të të përgatitet lista kontrolluese për këto pika të menaxhimit, do të kryhet intervista për operimin e SMCA-ve, si dhe do të rishikohet aftësia aktuale për menaxhimin e operimit dhe mirëmbajtjes së SMCA-ve.

Tabela 6. Pikat e rishikimit për kapacitetin e menaxhimit të SMCA-ve

Pikat për menaxhim	Përmbajtja e rishikimeve
(1) Plani i menaxhimit	Tabela e planit vjetor, tabela e planit mujor dhe tabela e planit javor
(2) Menaxhim i edukimit	Certifikimi teknik, plani dhe regjistri i edukimit
(3) Menaxhimi i SMCA-ve	Libri i menaxhimit të SMCA-ve (Lokacioni i stacioneve, Informacioni për emisionet në rrethinë të stacioneve, Data e instalimit, Elementet e monitoruara dhe Data e fillimit të monitorimit)
(4) Menaxhimi i Analizatorëve	Regjistri për analizatorë (klasa dhe lloji i analizatorëve, emri i prodhuesit, numri i prodhimit, data e prodhimit, parimi dhe metoda e matjes, shprehja e matjes, lloji i burimit të energjisë elektrike, sasia e energjisë elektrike, data e fillimit të matjes, data e analizës (data e ekzaminimit zyrtar), Regjistri i Gjurmëve për Analizatorë (Kontrolli periodik, Riparimi i përgjithshëm, Analiza, etj.)
(5) Menaxhimi i Operimit	Kontrolli ditor, Kontrolli periodik, Kontrolli urgjent, Testi i performancës, Kalibrimi dinamik, Regjistri i riparimeve nga prodhuesi
(6) Menaxhimi i të dhënave	Konfirmimi ditor i të dhënave të matjes, Kontrollimi i të dhënave, Trajtimi i vlerave të parregullta, Procedura e korigjimit dhe finalizimit etj.
(7) Kontrolli i gjurmueshmërisë	Regjistri për gazin standard me presion të lartë (Certifikimi i kalibrimit, lloji i gazit standard, përqendrimi i gazit standard, periudha e vlefshmërisë, etj.)

(8) Menaxhimi i komponentëve dhe materialeve shpenzuese	Statusi i kontrollit të inventarit (vendi i ruajtjes, sasi të, periudha e vlefshmërisë, etj.)
(9) Menaxhimi i pajisjeve testuese	Statusi i menaxhimit të pajisjeve siç janë pajisja rregulluese e gazit standard, matësi i rrjedhës, testuesi, etj.
(10) Menaxhimi i sigurisë	Statusi i ruajtjes, transportit dhe trajtimit të gazit standard me presi të lartë

Pas intervistimit për gjendjen e aktivitetit të menaxhimit të AQMS përmes ligjëratave, u gjykua se menaxhimi i punës për inspektimet ditore dhe periodike të SMCA-ve është veçanërisht i rëndësishëm, në përputhje me burimet e kufizuara të palës kosovare dhe karakteristikat e instrumenteve matëse standarde të BE-së të përdorura në Kosova.

Prandaj, apërgatitën regjistrin e të dhënave për inspektimet ditore dhe periodike duke iu referuar shembujve të Japonisë, dhe trajnimi në punë për inspektimin ditor u krye në lokacionet e SMCA-ve të cilat janë në operim duke përdorur librin tashmë të përgatitur të regjistrit.

Në bazë të këtyre aktiviteteve është bërë rishikimi për punët e menaxhimit të SMCA-ve. Rezultatet e rishikimit janë paraqitur në Tabelën 6.

Tabela 7. Rezultatet e rishikimit për Menaxhimin e SMCA-ve

Pikat për menaxhim	Rezultatet e Rishikimeve
(1) Plani i menaxhimit	Orari i punës nuk është përgatitur. Nuk ka asnjë tregues se janë kryer mirëmbajtja dhe inspektimet e planifikuara vjetore të SMCA-ve. Shpeshësia e zëvendësimit të filtrave të pluhurit gjithashtu nuk kryhet rregullisht: rreth tri javë në sezonin e dimrit kur ndodhin episode të ndotjes së madhe të ajrit dhe rreth një muaj në sezonin e verës. Kalibrimi i rregullt nuk kryhet, por kalibrimi për analizatorë matës kryhet kur ndizet sinjali i alarmimit ose kur konfirmohen të dhënat e parregullta përmes krahasimit me të dhënat e SMCA-së fqinje. Prandaj, u kuptua se është e nevojshme të krijohet një orar vjetor për inspektuar SMCA-të rregullisht dhe për t'i zëvendësuar në mënyrë sistematike materialet shpenzuese.
(2) Menaxhim i edukimit	Aktualisht dy anëtarë të H/L dhe një kompani e mirëmbajtjes

	<p>kryejnë mirëmbajtjen dhe inspektimet, por nuk është kryer asnjë menaxhim i planifikuar i edukimit.</p> <p>Për ta garantuar saktësinë e pajisjeve matëse, secili person përgjegjës për mirëmbajtjen duhet të ketë aftësi për mirëmbajtje dhe inspektim. Menaxhimi i edukimit është i rëndësishëm për t'i mbajtur aftësitë e mirëmbajtjes dhe inspektimit, dhe është i nevojshëm trajnim i sistematik.</p>
(3) Menaxhimi i SMCA-ve	<p>Libri i menaxhimit për SMCA nuk është përgatitur dhe informacioni për SMCA nuk ishte përpiluar. Është e rëndësishme të përgatitet libri i menaxhimit për SMCA që mundëson të kuptuarit e situatës së SMCA-ve pa shkuar tek lokacioni i SMCA-ve.</p>
(4) Menaxhimi i Analizatorëve	<p>Meqenëse nuk ka regjistër dhe regjistrime gjurmuese për analizatorët, dhënat e mirëmbajtjes dhe riparimit nuk mund të verifikohen. Prandaj, kuptua se saktësia e holluesit nuk mund të garantohet.</p>
(5) Menaxhimi i Operimit	<p>Libri i regjistrimit për inspektimet ditore dhe periodike nuk përdoret gjatë inspektimeve dhe detajet e inspektimeve në të kaluarën, informacioni për parametrat dhe të dhënat për zëvendësimin e pjesëve shpenzuese nuk dihen. Meqenëse nuk ka libër të regjistrimit, edhe nëse parregullsi në momentin e inspektimit, kjo regjistrohet në fletore në pronësi individuale, etj., dhe informacioni nuk mund të shkëmbehet. Për më tepër, meqenëse nuk ka të dhëna të inspektimeve periodike të kaluara, regjistrime të kalibrimit, etj., nuk mund të kuptohet gjendja e mirëmbajtjes së pajisjeve.</p> <p>Është e rëndësishme të mbahen shënime siç janë ato për mirëmbajtjen dhe inspektimet për ta kuptuar gjendjen e instrumenteve matëse.</p>
(6) Menaxhimi i të dhënave	<p>Edhe pse kontrolli ditor i të dhënave kryhet, kontrolli kryesor është konfirmimi i sinjalit të alarmimit dhe duket se nuk ka kontrole të të dhënave për orë të 24 orëve të fundit ose krahasim grafik i të dhënave në stacionet fqinje. Meqenëse kontrolli ditor i të dhënave është shumë i rëndësishëm për zbulimin e hershëm të shenjave të problemeve, kjo duhet të kryhet si punë rutinë.</p>
(7) Kontrolli i	<p>Meqenëse certifikata e gazit me presion të lartë nuk është ruajtur,</p>

gjurmueshmërisë	përqendrimi i gazit me presion të lartë të përdorur nuk mund të garantohet.
(8) Menaxhimi i pjesëve dhe materialeve shpenzuese	Edhe pse hapësira e magazinimit për materialet shpenzuese ndodhet brenda strukturës së SMCA-së, sasia e materialeve shpenzuese, pjesëve dhe informacionet e tjera nuk kontrollohet në regjistër ose përmes mënyrave të tjera. Si rezultat, është e vështirë të porositen pjesët e duhura dhe ekziston rreziku i mungesës së pjesëve.
(9) Menaxhimi i pajisjeve testuese	Meqenëse nuk mbahen regjistra për mirëmbajtjen e pajisjeve të hollimit etj., është e pamundur të konfirmohet nëse pajisjet e hollimit mirëmbahen apo jo. Meqenëse holluesit janë instrumente që kryejnë kalibrimin për të garantuar saktësinë e instrumenteve matëse dhe janë instrumente të rëndësishme që lidhen drejtpërdrejt me saktësinë e matjes për SMCA, është e nevojshme të zhvillohet libri i regjistrit për analizatorë.
(10) Menaxhimi i sigorisë	Bombolat e CO për kalibrim ruhen brenda kontejnerit të SMCA-së. Kushtet e ruajtjes janë të siguruara siç duhet me zinxhirë për të parandaluar që bombolat të rrëzohen dhe kryhet një test i rrjedhjes së gazit kur bombolat zëvendësohen.

Aktiviteti 4.3. Analiza të të dhënave të monitorimit të cilësisë së ajrit

Në bashkpunim me ekspertat e JICA-së u rishikuan rezultatet e analizës së të dhënave të monitorimit meteorologjik, të dhënat e monitorimit të cilësisë së ajrit dhe përgatitjen e raporteve mujore të cilësisë së ajrit në shtator 2022. Një përmbledhje e të dhënave të SMCA-ve të siguruara është paraqitur në 6

Tabela 8. Të dhënat nga SMCA të siguruara për analiza

	Pika	Periudha
Të dhënat meteorologjike	Temperatura, Drejtimi i erës, Shpejtësia e erës (Të dhënat për orë, Mesatarja mujore)	1/6/2020~30/6/2022
Të dhënat e cilësisë së ajrit	O ₃ , NO ₂ , SO ₂ , CO, PM _{2.5} , dhe PM ₁₀ (Të dhënat për orë, Mesatarja mujore)	1/1/2019~13/7/2022

Lokacioni i monitorimit	Brezovicë, Dardhishtë, Drenas, Gjilan, Hani i Elezit, Mitrovica, Obiliq, Palaj, Pejë, Prishtinë IHMK, Prishtina Rilindja, Prizren
--------------------------------	---

Të dhënat e monitorimit meteorologjik u krahasuan sipas lokacioneve të monitorimit, duke përdorur seritë kohore të temperaturës mesatare mujore, grafikun e shpërndarjes së frekuencës së shpejtësisë së erës, etj. Karakteristikat që ndryshonin nga lokacionet e tjera u theksuan për të diskutuar me dhe këshilluar për rëndësinë e kontrollit të të dhënave të monitorimit dhe regjistrave të mirëmbajtjes. Gjithashtu u kontrollua ndikimi i situatës gjeografike të lokacioneve të monitorimit në të dhënat e monitorimit.

Për sa i përket të dhënave të monitorimit të cilësisë së ajrit, me ndimën e ekspertave të cilët ka nëofruar këshilla për kontrollin e cilësisë në përpunimin e të dhënave të monitorimit, siç janë përcaktimi i vlerave të parregullta dhe përgatitja e vlerave përfundimtare, duke krahasuar vlerat e publikuara preliminare me vlerat e raportit mujor të cilësisë së ajrit.

Për sa i përket të dhënave të SMCA-ve, cilësia e të dhënave është përmirësuar që nga viti 2020 për shkak të rezultateve të Projektit të Fazës 1. Mirëpo, janë gjetur disa gabime në vlerat preliminare dhe vlerat e parregullta duket se raportohen në raportin mujor të cilësisë së ajrit. Prandaj, konsiderohet e nevojshme të vazhdohet me zhvillimin e kapaciteteve lidhur me heqjen e vlerave të parregullta, përgatitjen e vlerave përfundimtare dhe konsistencën me raportin mujor.

Tabela 8. Rezultatet e rishikimit për Laboratorin mjedisor

Pikat për menaxhim	Rezultatet e Rishikimeve
Laboratori mjedisor	<p>Statusi i operimit të ICP-MS dhe kontrolli i operimit: Identifikimi i problemeve</p> <p>Kontrolli i operimit të IC: Identifikimi i problemeve dhe IHMK po i trajtohet.</p> <p>Nga pikëpamja e konfirmimit të të gjithë laboratorit mjedisor, statusi dhe gjendja e mirëmbajtjes së secilës dhomë për analiza: jo i mjaftueshëm</p>
Analizatori	<p>Konfirmimi i pajisjeve të prodhimit të ujit të pastër: Konfirmimi i kontaminimit të filtrit</p> <p>Statusi i operimit të pajisjeve për analiza si IC dhe ICP-MS: jo funksional</p> <p>Statusi i përdorimit të pajisjeve të para-trajtimin të analizave: jo funksional</p> <p>Reagjentët, tretësirat standarde, gazrat standarde etj.: menaxhim i pamjaftueshëm</p>

Kontrolli i cilësisë	Kontrolli i cilësisë për analizën e përgjithshme të matjeve mjedisore Llogaritja praktike për kontrollin e saktësisë së analizave të matjeve mjedisore siç janë devijimi standard, koeficienti i variacionit, koeficienti i korrelacionit, formula e regresionit dhe lakorja e kalibrimit.
----------------------	---

2.2. PROGRES KUNDREJT OBJEKTIVIT 2: Ulja e emisioneve nga burimet e veçanta

Emisionet e NO_x, SO₂ dhe pluhurit në shtetin tonë janë kryesisht të larta për shkak të burimeve të veçanta të emisioneve. MMPHI do të përpiqet të mbështesë kontrollet e nevojshme në termocentralet dhe impiantet tjera, përmes partneriteteve dhe mbështetjes së veprimeve legislative. Në këtë drejtim, me mbështetjen e investimeve në sistemin monitorues të ndotësve, planifikohet përmirësimi i teknologjive në sektorin e energjetikës, hulumtime në zëvendësimin e karburanteve me lëndëve djegëse më të pastërta (përmbajtje të S- më të ulët), etj.

Aktiviteti 2.1. Organizimi i punëtorive dhe tryezave me operatorët dhe palët e interesuara

Me projektin- Zhvillimi i Kapaciteteve për Kontrollin e Ndotjes së Ajrit në Republikën e Kosovës të mbështetur nga donacioni i Agjencionit Japonez për Bashkëpunim Ndërkombëtar (JICA) janë organizuar seminare për industrinë vecanarisht në sektorin e energjisë dhe për disa industri tjera si për fabrikat private, agjencitë private për matje, Universitetin, etj. për sa i përket matjes së gazit të shkarkuar.

Seminaret për masat për zvogëlimin e emisioneve janë përsëritur shumë herë gjatë per stafin përgjegjës në KEK, te cilet kanë përmirësuar njohurinë e tyre dhe kanë thelluar të kuptuarit e tyre.

Tabela 9. Seminari për matjen e gazit të shkarkuar

Data	Aktiviteti	Vërejtjet
13 shkurt 2020 (e enjte) 9:00 ~ 12:00	Seminari për matjen e gazit të shkarkuar për operatorët privatë, Universitetin, etj.	Kompanitë dhe Universiteti

Akticiteti 2.2. Përcaktimi i masave për kontrollin e emisioneve në instalimet që janë subjekt i Parandalimit dhe Kontrollit të Integruar të Ndotjes (PKIN)

Masat e kontrollit të ndotjes për Impiantet me Dijegie të Madhe dhe për burimet tjera stacionare MEA fillimisht ka filluar me sektorin e prodhimit të energjisë si sektor me rëndësi ekonomike dhe sociale për Reapublikën e Kosovës, veçanarisht në TC Kosova A. Ky aktivitet poashtu është duke u mbështetur nga projekti i JICA- Zhvillimi i Kapaciteteve për Kontrollin e ndotjes së ajrit në Republikën e Kosovës. Ndërsa për rehabilitimin e TC Kosova B është kry Studimi i Fizibilitetit të TC Kosova B, i mbështetur nga Bashkimi Evropian, i cili poashtu do ta mbështet edhe rehabilitimin e këtij termocentrali.

Projekti ka studiuar masat për zvogëlimin e emisioneve vetëm për TC Kosova A. Në periudhën e parë është bërë shqyrtimi i masave për zvogëlimin e emisioneve përmes matjes së gazit të shkarkuar për SO₂, NO_X dhe Pluhur, regjistrimet e detajuara të operimit të kaldajave si dhe mostrimi dhe analiza e linjtit dhe hirit fluturues. Në këto aktivitete janë propozuar masat për zvogëlimin e Pluhurit siç është përmirësimi i efikasitetit të mbledhjes së Pluhurit të Fundërruesit Elektro-Statik (këtu e tutje “FES”). Këto masa janë: përmirësimi i shpërndarjes së shpejtësisë brenda FES-ve, modifikimi i sistemit të energjizimit elektrik dhe zvogëlimi i shkallës së rrjedhës së gazit të shkarkuar përmes përmirësimit të operimit. Këto supozohet të jenë shkaqet kryesore të rënies së efikasitetit.

Në periudhën e dytë TC Kosova A pranoi rekomandimin. TC Kosova ka kryer modifikimin për përmirësimin e shpërndarjes së shpejtësisë brenda FES-ve në njërin nga FES-ët, dhe si rezultat i testit është konfirmuar efektiviteti i modifikimit dhe zvogëlimi i shkallës së rrjedhës së gazit të shkarkuar. Mirëpo, modifikimi i sistemit të energjizimit elektrik ka mbetur pa u kryer për shkak se nuk ka pasur përgjigje nga prodhuesi i FES-it. Mirëpo, në periudhën e tretë u bë i mundshëm kontakti me prodhuesin e FES-it dhe negociatat kanë filluar. Në të ardhmen pritet aplikimi i këtij sistemi të energjizimit elektrik. Modifikimi për përmirësimin e shpërndarjes së shpejtësisë brenda FES-ve tani është duke iu aplikuar FES-ve një nga një. Për më tepër, kur të aplikohet sistemi i energjizimit elektrik pritet zvogëlimi i madh i Pluhurit. Këto masa u bënë një nga rezultatet e mëdha të Projektit. Për sa i përket SO₂ dhe NO_X, megjithëse Projekti ka propozuar masat për zvogëlim, këto masa kërkojnë investime për rinovimin e pajisjeve dhe kjo aktualisht është çështje problematike

2.3. PROGRES KUNDREJT OBJEKTIVIT 3: Ulja e emisioneve nga burimet Mobile

Me projektin- Zhvillimi i Kapaciteteve për Kontrolli i Ndotjes së Ajrin në Republikën e Kosovës të mbështetur nga donacioni i Agjencionit Japonez për Bashkëpunim Ndërkombëtar (JICA), janë punuar fletet e Vlerësimit të Masave nga burimet mobile.


Tabela 1. Rregulloret Euro për Emisione për Automjete

Pika	Metoda e Vlerësimit
Pasqyra	Kjo është masë për t'i zëvendësuar të gjitha automjetet pa Rregullore Euro për Emisione, me Rregullore Euro I për Emisione dhe Rregullore Euro II për Emisione, me automjete me Rregullore Euro III për Emisione. Pasi që rregulloret për emisione të automjeteve do të bëhen më të rrepta, ndotësit e shkarkuar në ajër nga automjetet do të zvogëlohen.
Skenari	Automjetet e synuara janë të gjitha llojet. Vlerat në vijim janë numri total i automjeteve të synuara në zonën e Prishtinës. Mirëpo, zvogëlimet e emisioneve janë llogaritur vetëm për zonën e synuar. Këto automjete do të zëvendësohen me automjete të cilat përmbushin Rregullorja Euro 3 për Emisione.

Zona e Prishtinës		Total	para Euro 1	Euro 1	Euro 2	Euro 3	Euro 4	Euro 5	Euro 6
Veturë për pasagjerë (M1)	Benzinë	12502	2205	508	1540	4039	2688	1105	416
	Naftë	49473	8726	2011	6093	15985	10638	4373	1646
	LPG	358	63	15	44	116	77	32	12
	Tjetër	189	33	8	23	61	41	17	6
KLK (N1)	Benzinë	129	17	14	33	37	20	6	1
	Naftë	7701	1018	837	1991	2210	1207	358	81
	Tjetër	4	1	0	1	1	1	0	0
KRR (N2-N3)	Naftë	3007	798	291	586	842	239	203	51
	Tjetër	2	1	0	0	1	0	0	0
Autobus (M2-M3)	Naftë	706	97	94	248	180	43	28	16
	CNG (Autobus)	0	0	0	0	0	0	0	0
	Tjetër	3	0	0	1	1	0	0	0
Motoçikletë (L)	Benzinë	515	118	102	71	179	40	0	2
	Tjetër	5	1	1	1	2	0	0	0

Para

Pas



Vlera kufitare për shëndetin e njeriut
Mesatarja vjetore: jo më shumë se $40\mu\text{g}/\text{m}^3$

Figura 5. Harta e zvogëlimi te emisioneve të PM10 dhe Harta e Përqendrimit të PM10 para-pas

Tabela 11. Fleta e Vlerësimit për Rregulloren me Numër të Targës

Pika	Metoda e Vlerësimit
Pasqyra	<p>Veturat me numër çift të targës mund të hyjnë në qytet në ditët çift</p> <p>Veturat me numër tek të targës mund të hyjnë në qytet në ditët tek</p> <p>Zona e synuar: Qendra e Prishtinës</p>
Skenari	<p>1) Duke e thjeshtëzuar, vëllimi i automjeteve do të përgjysmohet, por në përgjithësi do të ndodhin kërkesa shtesë, kështu që nuk do të jetë përgjysmë.</p> <p>2) Vetura e pasagjerëve (VP) dhe Kombi: 25% e përdoruesve të VP dhe Kombi do të kalojnë nga përdorimi i VP dhe Kombi në përdorim të Autobusëve, të tjerët përdorin në vazhdimësi VP dhe Kombi. Kjo do të thotë se do të ketë 25% zvogëlim në Vëllimin e VP dhe Kombi.</p> <p>3) Numri i Kamionëve të Lehtë Komercialë (KLK) dhe Kamionëve të Rëndë Komercialë (KRR) do të ketë 50% zvogëlim (Numri do të jetë gjysma e vëllimit).</p> <p>4) Pasi që Autobusët janë pjesë e sistemit të transportit p frublik, të gjithë autobusët mund të shfrytëzohen nën rregulloren e numrit të targës së Automjetit.</p> <p>5) Numri i Autobusëve rritet bazuar në kapacitetin për pasagjerë të Autobusëve dhe numrit të personave të cilët kalojnë nga përdorimi i VP dhe Kombi në përdorim të Autobusëve.</p> <p>6) Numri i këtyre personave shumëzohet me 3 persona/VP dhe 6 persona/Kombi me vëllimin prej 25% të Numrit të VP dhe Kombi.</p>

2.4. PROGRES KUNDREJT OBJEKTIVIT 5: Ulja e emisioneve nga aktivitetet publike

Për promovimin e ndryshimit të sjelljes së publikut në përgjithësi, për të ulë emetimet janë organizuar një sërë takimesh, tryeza të rrumbullakta duke përfshirë edhe shoqërinë civile. Poashtu ka pasë edhe emisione televizive për të njoftuar qytetarët për gjendjen e cilësisë së ajrit, për masat që janë duke u ndërmarr nga Qeveria për përmirësimin e cilësisë së ajrit dhe mënyrën se si duhet të mbrohen qytetarët në raste kur përkeqësohet cilësia e ajrit.

Komuna e Prishtinës në vitin 2022, si pjesë e implementimit të Planit të Mobilitetit ka nënshkruar kontratën për blerjen e 34 autobusave, 10 prej tyre elektronik dhe 24 të tipit Euro VI.

Po ashtu si pjesë e realizimit të Planit të mobilitetit ka ndërmarr aktivitete në lidhje me krijimin e shtigjeve të bicikletave me lagjet e ndryshme të Prishtinës dhe riorganizimin e transportit publik.

RREZIQUET DHE HAPAT PËR ADRESIMIN E TYRE

Strukturat ekzistuese brenda institucioneve zbatuese të aktiviteteve, janë një bazë solide për të siguruar një lidhje konsekuente të aktiviteteve konkrete në terren, në nivelin e politikës

Për të stabilizuar më tej lidhjet dhe komunikimin dhe rrjedhën e informacionit dhe për të ta shtri atë tek akterët përtej institucioneve është një objektiv kryesor i sistemit të zbatimit të Strategjisë për Cilësinë e Ajrit.

Shkëmbimi i informacioneve dhe zbatimit të aktiviteteve midis institucioneve, është propozuar nga MMPHI, që nga fillimi. Duket se ka nevojë për një horizont më formal shkëmbimi, pasi shumica e palëve të interesit pohojnë se është jashtë kapaciteteve të tyre për të nxitur një shkëmbim horizontal.

Shkëmbimi i informatave dhe bashkëpunimi në realizimin e aktiviteteve në mes palëve pjesërisht ekziston. Gjatë takimeve të vitit 2022, këto çështje janë prezantuar, për të kapërcyer këto mangësi të dukshme. Në fund mund të thuhet se:

Kontributet e dhëna nga palët e interesit, duke përfshirë përfaqësues nga institucionet qendrore dhe lokale, bizneset dhe shoqërisë civile me Strategjinë dhe Planin e Veprimit për Cilësinë e Ajrit do të udhëheqen programet, politikat dhe aktivitetet për të zvogëluar emetimet e shkarkuara në ajër, që të ndihmojë Kosovën që në një masë të përmbush standardet e parapara me legjislacionin për ajër dhe të përmirësohet cilësia e ajrit në të ardhme në Kosovë.

Me udhëzime nga diskutimet e shumta dhe të ekspertëve ndërkombëtar, Plani i Veprimit për Cilësinë e Ajrit do të përditësohet periodikisht për të ndihmuar të krijojmë një të ardhmen më të shëndoshë të mundshme për vendin tonë.

Shtojca 1.**RAPORTI I MONITORIMIT TË PLANIT TË VEPRIMIT PËR VITIN 2022 -
MODELI PËR PROGRESIN KUNDREJT VEPRIMEVE**

Nr.	Objektivat dhe veprimet	Afati i fundit	Burimi financiar	Institucioni udhëheqësi dhe mbështetës	Produkti (Output)	Referenca në dokumente	Progresi në zbatim
I.	Objektivi strategjik: 1	Zbatimi i legjislacionit për ajër					
I.1.	Objektivi specifik	Krijimi i Sistemit për menaxhimin e cilësisë së ajrit					
I.1.1.	Përgatitja e Inventarit të ajrit	2022	Mbështetje (donacion) e Agjencionit Japonez për bashkëpunim Ndërkombëtar (JICA)	MMPHI Ekspertët e JICA-s	Krijimi i Inventarit të emisioneve në ajër	Ligji për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja, Nr. 08/L-025 Strategjia për Cilësinë e Ajrit 2013-2022	Aktiviteti është zhvilluar sipas planifikimit

I.1.2.	Vlerësimi i cilësisë së ajrit dhe parashikimet e ndotjes - modelim/simulimet	2022	Mbështetje (donacion) e Agjencionit Japonez për bashkëpunim Ndërkombëtar (JICA)	MMPHI, Ekspertët e JICA-s	Zyrtarë të MMPHI të trajnuar për modelim/simulimet	Ligji për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja, Nr. 08/L-025 Strategjia për Cilësinë e Ajrit 2013-2022	Aktiviteti është zhvilluar sipas planifikimit
I.1.3.	Draftimi i Planit Lokal i Veprimit për Cilësinë e ajrit- Komuna e Prishtinës	2022		MMPHI, Komuna e Prishtinës		Ligji për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja, Nr. 08/L-025 Strategjia për Cilësinë e Ajrit 2013-2022	Aktiviteti është zhvilluar sipas planifikimit dhe pritet të finalizohet
I.2.	Objektivi specifik	Krijimi Sistemit për menaxhimin e cilësisë së ajrit					
I.2.1.	Zhvillimi i sistemit për matjen e	2022	Mbështetje (donacion) e Agjencionit	MMPHI, Ekspertët e JICA-s	Analiza e kryer dhe Stacionet për	Ligji për Mbrojtjen e Ajrit nga	Aktiviteti është zhvilluar

	emisioneve në industri		Japonez për bashkëpunim Ndërkombëtar (JICA)		monitorimin e cilësisë së ajrit të riparuar duke përfshirë edhe ndërtimin e rrjetit të komunikimit të të dhënave	Ndotja, Nr. 08/L-025	sipas planifikimit
II.3.	Objektivi specifik	Zvogëlimi i ndotjes së ajrit nga industria- Mbështetje e industrive për aplikimin e Teknikave më të Mira që janë në dispozicion me qëllim të arritjes së vlerave kufitare të emisioneve					
II.3.1.	Organizimi i punëtorive virtuale me ekspertat lidhur me emizionet nga fermat e pulave.	2022	Project Skat Consulting Ltd, Integrated Water Resources Management in Kosovo (IWRM-K)	MMPHI	Organizimi i puntorive	Strategjia për Cilësinë e Ajrit 2013-2022	Aktiviteti është zhvilluar sipas planifikimit

II.3.2.	Këshilla me operator për dokumentet e nevojshme dhe procedurat për tu paisur me LMI si dhe konsulta lidhur me zbatimin e IED.	2022	MMPHI	MMPHI	Operatorët e njoftuar për aplikimin e Teknikave më të Mira në Dispozicion (BAT) dhe Dokumente Referente të BAT-BREF	Strategjia për Cilësinë e Ajrit 2013-2022, Ligji për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja, Ligji për Parandalimin dhe Kontrollin e Integruar të Ndotjes	Aktiviteti është zhvilluar sipas planifikimit
III.	Objektivi strategjik:	Ulja e emisioneve nga burime mobile					
III.1.	Objektivi specifik	Zvogëlimi i emisioneve nga automjetet publike, në veçanti të autobusëve dhe taksive					
III.1.1.	Largimi i autobusëve të vjetër nga qarkullimi si pjesë e Implementimit të planit të mobilitetit	2022	Komuna e Prishtinës (pilot projekt), MMPHI, MF	Komuna e Prishtinës	Plani i mobilitetit të qëndrueshëm për Komunën e Prishtinës	Strategjia për Cilësinë e Ajrit 2013-2022	Është kryer plani për mobilitet të qëndrueshëm për Komunën e Prishtinës,

							në implemetim e sipër
III.1.2.	Shtimi dhe lidhja e lagjeve me shtigje të bicikletave	2022	Komuna e Prishtinës	Komuna e Prishtinës	Plani i mobilitetit të qëndrueshëm për Komunën e Prishtinës	Strategjia për Cilësinë e Ajrit 2013-2022	Në implemetim e sipër
III.3.4.3.	Nënshkrimi i kontrarës për blerjen e 34 autobusëve (10 elektrik dhe 24 Euro VI	2022	Komuna e Prishtinës	Komuna e Prishtinës	Blerja e autobusëve	Strategjia për Cilësinë e Ajrit 2013-2022	Si pjesë e realizimit të plani për mobilitet të qëndrueshëm për Komunën e Prishtinës
III.3.	Objektivi specifik	Çasje e kufizuar në zonat e ndotura urbane për automjetet me ndotje të lartë					
III.3.1.	Rishikimi dhe organizimi i transportit publik	2022	Komuna e Prishtinës (MMPHI, MF)	Komuna e Prishtinës	Plani i mobilitetit të qëndrueshëm për Komunën e Prishtinës	Strategjia për Cilësinë e Ajrit 2013-2022	Në imlementim sipas planit të mobilitetit të Komunës së Prishtinës

